R E L A C I O N

PËR

P R O J E K T V E N D I M

Nr.____, datë ___/___/2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT "KUJDESI I DUHUR", TË RREGULLOREVE FLEGT DHE EUDR, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE DHE INSTITUCIONEVE PËRKATËSE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për zbatimin në Republikën e Shqipërisë të Rregullores (BE) 2023/1115 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 31 maj 2023, si dhe të Rregullores (KE) nr. 2173/2005 për krijimin e skemës së licencimit FLEGT, dhe të rregullojë autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Gjithashtu ndër të tjera, ky projekvendim ka si qëllim që të përcaktojë:

a) rregullat dhe procedurat për dokumentimin, gjurmueshmërinë, kontrollin dhe verifikimin e përputhshmërisë së mallrave përkatëse dhe produkteve përkatëse me kërkesat e Rregullores (BE) 2023/1115;
b) rregullat dhe procedurat për zbatimin e sistemit të kujdesit të duhur nga operatorët, operatorët pasues dhe tregtarët, sipas parashikimeve të këtij vendimi;
c) rregullat dhe procedurat për verifikimin e licencave FLEGT për importet e produkteve të drurit nga vendet që zbatojnë skemën përkatëse;
d) autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për bashkërendimin, kontrollin, inspektimin, verifikimin, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit në kuadër të zbatimit të këtij vendimi;

Objektivi primar i projektvendimit ka të bëjë me procedurat e bashkërendimit ndërinstitucional për zbatimin e akteve të Bashkimit Evropian në fushën e

mallrave dhe produkteve që lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve, për aq sa bëhen të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Po ashtu në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ky vendim ka objektiv që të kontribuojë në parandalimin e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve, në reduktimin e ndikimeve negative mbi klimën dhe biodiversitetin, si dhe në garantimin që mallrat përkatëse dhe produktet përkatëse të vendosura në treg ose të eksportuara të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026, të miratuar me VKM nr. 812, datë 30.12.2025.

Ky projektakt është në përputhje me drejtimet kryesore të programit politik të Këshillit të Ministrave, që synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e efikasitetit në administratën publike, si dhe përmirësimin e mekanizmave të qeverisjes dhe llogaridhënies në sektorët strategjikë, përfshirë atë të pyjeve dhe kullotave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi dhe hartimi i tij lidhen me detyrimet që ka vendi ynë në fushën e përarfrimit të legjislacionit kombëtar në përputhje me atë europian. Projektvendimi në tërësinë e tij garanton të drejtën e subjekteve tregëtare në fushën e tregëtimit të produkteve pyjore, për të kryer trasaksione të ndërsjellta në tregun e përbashkët të BE.

Ky projekvendim është një tregues domethënës dhe angazhim në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, duke shpalosur një ambicie të theksuar në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe standardeve sektoriale;

Po ashtu, projektvendimi synon të japë zgjidhje sa i takon problematikave në lidhje me harmonizimin e mëtejshëm me acquis dhe instrumentet kryesore të

Bashkimit Evropian, përfshirë direktivat në fushën e ekosistemeve, pyjeve, habitateve, shpendëve dhe ujërave, duke krijuar një bazë më të fortë ligjore për përafrim dhe duke shmangur interpretimet e paqarta në praktikë.
Po ashtu, projektvendimi parashikohet të ketë efekte pozitive sa i takon integrimit të të dhënave sektoriale ndërmjet institucioneve të ndryshme, duke çuar në një nivel tjetër ndërveprimin e sistemeve, duke reduktuar kohën, duke rritur performancën dhe transparencën.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi del në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, shkronjës b, të pikës 8 të nenit 27 dhe pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 57/2020, "Për Pyjet", i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* E BE-së (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim synon përafrimin me *acquis* e BE-së, dhe specifikisht Rregullores (BE) 2023/1115 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 31 maj 2023, si dhe të Rregullores (KE) nr. 2173/2005 për krijimin e skemës së licencimit FLEGT.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i kompozuar në 8 (tetë) krerë, 37 nene dhe 4 anekse. Theksojmë se dispozita e parashikuar në titull të projektvendimit për "kujdesin e duhur", është pjesë përbërëse e vete rregulloreve të cilat shtjellohen në këtë projektvendim dhe si pasojë ajo nuk është e shtjelluar si pjesë më vehte.

Sa i takon përmbajtjes së projektvendimit sipas strukturës në të cilin ai formuluar, ai është si më poshtë vijon:

Kreu I, "Dispozita të përgjithshme", përbëhet nga 4 nene, ku specifikisht në nenin 1, jepet qëllimi dhe objekti i projektvendimit, në nenin 2 përcaktohet fusha e zbatimit të këtij projektvendimi dhe në nenin 3 jepem përkufizimet për secilin

term të përdorur në këtë projektvendim. Në total janë përkufizuar 48 terma që janë përdorur në këtë projektvendim. Ndërsa në nenin 4 janë përcaktuar kufizimet dhe kushtet për hedhjen në treg të produkteve drusore që lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve.

Kreu i II, "Mbi detyrimet e operatorëve, operatorëve pasues dhe tregtarëve për tregëtimin dhe eksportin e produkteve që lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve (EUDR)", është kompozuar nga vetëm 11 nene (neni 5-neni 15), ku në nenin 5 përcaktohen detyrimet e operatorëve. Në nenin 6, përcaktohen kushtet për regjimet e thjeshtuara për operatorët parësorë dhe ato të vegjël.

Në nenin 7, përcaktohen kushtet dhe detyrimet e operatorëve pasues dhe tregëtarëve.

Në nenin 8, jepen të dhëna në lidhje me "përfaqësuesin e autorizuar", ku çdo subjekt (operator) ka të drejtë të autorizojë apo të mandatojë një përfaqësues zyrtar në lidhje me paraqitjen e deklaratës së kujdesit të duhur në emër dhe për llogari të tij.

Në nenin 9, shtjellohen procedurat në rastin kur hedhja në treg e produktit bëhet nga persona të vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 10, sqarohet deklarata e "Kujdesit të duhur"që operatori e plotëson paraprakisht.

Në nenin 11, saksionohet kërkesat për informacion rreth produktit që hidhet në treg.

Në nenin 12, "Vlerësimi i rrezikut", përshkruhen rastet mbi të cilat operatori vlerëson rrezikun që produkti të jetë marrë nga burime jo të ligjshme, gjë që përbën edhe fazën e parë kur institucioni kompetent mund të gjykojë mbi kontrollin mbi nivelin e rrezikut.

Në nenin 13, përcaktohen masat për zbutjen (zvogëlimin) e rrezikut, i cili paracakton edhe të drejtën për kontrolle teknike dhe administrative nga institucioni kompetent.

Në nenin 14, përcaktohen rregullat për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kujdesit të duhur, raportimin dhe ruajtjen e dokumentacionit respektiv.

Në nenin 15, përcaktohet se kur operatorët i nënshtrohen një procedure të thjeshtuar në lidhje me deklarimet e kujdesit të duhur.

Kreu III, "Autoriteti kompetent, institucionet përgjegjëse, kontrollet, masat dhe raportimi", kompozohet nga 10 nene (neni 16 – neni 25) dhe projektakti synon të rregullojë të gjithë konturin administrativ dhe institucional të procesit dhe konkretisht:

Në nenin 16, përcaktohen se cilat janë autoritetet dhe institucionet përgjegjëse.

Në nenin 17, përcaktohen rregullat e komunikimit ndërmjet autoriteteve dhe institucioneve përgjegjës në lidhje me dhënien e asistencës teknike, udhëzimet, shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi dhe raportimi.

Në nenin 18, përcaktohen kushtet në të cilat autorite kompetent duhet te kryejë kontrollet dhe planin vjetor për kontrolle.

Në nenin 19, përcaktohen kushtet kur autoriteti kompetent duhet të ndërhyjë në mënyrë të menjëhershme në rastet ku konstaton pa-pajtueshmëri dhe mospërputhje me të dhënat e deklaruara nën siglën e kujdesit të duhur.

Në nenin 20, përcaktohen rastet se kur do të ndërhyhet me kontrolle për operatorët dhe si organizohen ato.

Në nenin 21, përcaktohen rastet kur ushtrohen kontrolle tek operatorët pasues dhe tregëtarët.

Në nenin 22, përcaktohen rastet se kujt i ngarkohen kostot e kontrolleve që ushtrohen tek operatorët.

Në nenin 23, përcaktohen rasten se kur autoriteti përgjegjës jep masa të përkohshme për operatorët.

Në nenin 24, përcaktohen rastet se kur autoriteti kompetent jep masa korrektuese për operatorët në rastin kur konstatohen mos-përputhje.

Në nenin 25, përcaktohet se kur autoriteti jep sanksione administrative dhe masa plotësuese për operatorët, në rastet kur konstatohen mos-përputhshmëri.

Kreu IV, "Procedurat për produktet përkatëse qe hyjnë ose dalin nga tregu", është i organizuar në 2 nene, përkatësisht neni 26 dhe ai 27.

Në nenin 26, përcaktohen mënyra e organizimit të kontrolleve doganorë dhe shkëmbimit të informacionit nëpërmjet ndërfaqeve zyrtare.

Në nenin 27, përcaktohen mënyrat dhe detyrimi për të shkëmbyer informacionin reciprok midis autoriteteve kompetente.

Kreu V, "Sistemi i vlerësimit dhe bashkëpunimi me vendet e treta", është organizuar në dy nene. Neni 28 dhe ai 29.

Në nenin 28, projektvendimi qartëson procedurat e kategorizimit të vendeve sipas nivelit të rrezikut.

Në nenin 29, përcaktohen mënyrat e bashkëpunimit teknik dhe administrativ me vendet e treta.

Kreu VI, "Shqetësimet e arsyetuara dhe aksesi në drejtësi", është i konceptuar dhe shtjelluar në 2 nene.

Në nenin 30, përcaktohen rastet se kur operatorët mund të paraqitin shqetësimit e arsyetuara të tyre dhe rastet kur ato merren në shqyrtim nga autoriteti.

Në nenin 31, përcaktohen e drejta e operatorëve për ankimim administrativ dhe gjyqësor.

Kreu VII, "Regjimi FLEGT" është organizuar në 4 nene (32-36).

Në nenin 32, përcaktohen fushat dhe rastet konkrete se kur zbatohet regjimi i FLEGT.

Në nenin 33, përcaktohen rastet dhe kushtet e importit me licencë FLEGT dhe përjashtimi për produktet e mbuluara nga CITES

Në nenin 34, përcaktohen rastet dhe detyrimet e operatorëve për të paraqitur licensën FLEGT tek autoriteti doganor.

Në nenin 35, përcaktohen rastet dhe pasojat e mospërmbushjes, njoftimi dhe raportimi në kuadër të regjimit FLEGT.

Kreu VIII, "Dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi", është kreu i fundit dhe është i organizuar në 2 nene (36 dhe 37).

Në nenin 36, përcaktohen dispozitat kalimtare, në të cilat janë përcaktuar kushtet e zbatimit dhe të hyrjes në fuqi të këtij projektvendimi.

Në nenin 37, përcaktohet se kur ky projektvendim hyn në fuqi dhe kur ai fillon të zbatohet.

Për sa më sipër projektvendimi është i organizuar edhe në 4 anekse të tjera, ku më aneksin e parë jepen mallrat dhe nomeklatura e tyre që i nënshtrohen këtij projektvendimi. Vetë ky aneks është i organizuar në 2 nën-anekse të tjera ku:

Në aneksin 1/1 jepen jepen lista e produkteve të drurit, ku skema FLEGT aplikohet pavarësisht cilësimit të vendit partner.

Në aneksin 1/2 jepen produktet e drurit për të cilat skema e licencimit FLEGT zbatohet vetëm në lidhje me vendet partnere përkatëse.

Në aneksin 2, "Deklarata e kujdesit të duhur" përcaktohen të dhënat që duhet të përmbajë deklarata e kujdesit të duhur, në përputhje me nenin 5, pika 2, të këtij vendimi.

Në aneksin 3, "Deklarata e thjeshtuar për operatorët parësorë mikro ose të vegjël", përcaktohen të dhënat që duhet të përmbajë deklarata e thjeshtuar e paraqitur një herë të vetme për operatorët parësorë mikro ose të vegjël, në përputhje me nenin 6, pika 2, të këtij vendimi.

Në aneksin 4, "Kërkesat minimale për gjeolokacionin", përcaktohen detyrime dhe përcaktime në lidhje me aplikimin e vendodhjes ose gjeolokacionit të parcelave përkatëse të tokës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimit ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, NJQV-të.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mjedisit, si ministria përgjegjëse për fushën e pyjeve.
Projektvendimi ka kaluar në fazën e konsultimit publik në datën 18 Qershor 2026 dhe, pas mbarimit të afatit ligjor të këtij procesi, theksojmë se nuk ka patur asnjë reagim apo koment ne lidhje me këtë projektvendim.

Projektvendimi dërgohet për mendim në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrine e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projekvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

SOFJAN JAUPAJ

